



Kontrate Mbikqyrje Punimesh

E lidhur sot me date 30/10/2014 midis paleve te meposhtme:

Bashkia Kruje qe do te quhet **Investitor**, perfaqesuar nga z. **Shkelzen Hoxha**, Kryetar i Bashkise Kruje dhe ne cilesine e kryetarit te Autoritetit Kontraktor

Dhe

Shoqerise "Derbi E" shpk me license MK.1713/3 " Per mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi", leshuar me date 21.01.2013 nga Ministria e Puneve Publike dhe Transportit - Komisioni i Dhenies se Licensave profesionale - i cili do te quhet me poshte Mbikqyres i Punimeve te Ndertimit, e perfaqesuar nga Z. **Florian Ravoniku** me autorizimin e leshuar nga Ing Bexhet Dedja me dt. 30.10.2014.

Neni 1

Objekti dhe vlera e kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte **Mbikqyrja e punimeve te ndertimit per objektin "Sistemim dhe ndricim i rruges se Malit, rruga Kalaja, Kruje"**.

Vlera e kontrates eshte **125.000 (njqind e njetzet e pese mije)leke pa t.v.sh ,dhe 150.000 (njqind e pesedhjetete mije) leke me t.v.sh..**

Neni 2

Baza ligjore

Udhezimi nr. 3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar me udhezimin nr.1 date 16.6.2011.

Neni 3

Gjuha dhe legjislacioni

Kontrata perpilohet ne gjuhen shqipe, legjislacioni qe zbatohet eshte ai shqiptar.





Neni 4

Komunikimi

Komunikimi mes paleve referuese ne kushtet e kontrates do te jete efektiv vetem kur behet me shkrim. Njoftimi do te quhet efektiv vetem kur transmetohet.

Neni 5

Pegjegjesite e mbikqyresit

Mbikqyresi eshte pergjegjes per realizimin e punimeve ne baze te Udhezimit nr. 3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar me udhezimin nr.1 date 16.6.2011.

Ai ka per detyre te kontrolloje zbatimin e punimeve te ndertimit.

Neni 6

Kontrata e sipermarrjes

Mbikqyresi nuk merr pjese ne hartimin e kontrates se sipermarrjes.

Neni 7

Pagesa

Pagesa do te kryhet me urdher – xhirimi ne llogarine e mbikqyresit te punimeve .

Neni 8

Taksat

Mbikqyresi i punimeve duhet te paguaje te gjitha tatimet dhe taksat sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 9

Paradhenia

Investitori nuk paguan paradhenie.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarreshjeve

Investitori dhe mbikqyresi i punimeve duhet te perpiqen te zgjidhin ne menyre paqesore mosmarreshjet lidhur me kontraten.

Ne rast te kundert mosmarreshja do te zgjidhet nga Gjykata e Riethitn Gjyqesor Kruje.





Neni 11

Te pergjithshme

Kontrata hartohet ne tre kopje, dy prej te cilave i mban Investitori dhe nje Mbikqyresi i Punimeve.

Kontrata nenshkruhet me vullnetin e lire te paleve.

Per Mbikqyresin e Punimeve

Florian Ravoniku



Investitori

Bashkia Kruje

Kryetari

Shkelzen Hoxha

